

85H-1

K 52

VJERSHA

A stylized white silhouette of a worker in a hard hat and work clothes, standing on a platform or structure. The background is a solid red color. To the left and right of the worker are white geometric patterns representing industrial structures, such as towers or scaffolding. The overall style is graphic and minimalist.

**KENGE E  
THJESHTË**

891.983-1

KBZ

J

# KËNGË E THJESHTË

(VIERSHA)

~~52343~~

LIBRARI E [REDACTED]  
129 F6

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## DY FJALË LEXUESIT

*Ky vëllim me poezi, është pregatitur nga rrethi letrar i qytetit të Durrësit në kuadrin e njëzet e pesë vjetorit të çlirimit të Atdheut. Janë përfshirë poezi, për fëmijë të moshës shkollore, shkruar nga anëtarë të rrethit letrar dhe nxënës të shkollave tetëvjeçare e të mesme të qytetit tonë. Shumica e këtyre letrarëve i muarën në dorë penat për herë të parë dhe hodhën në vargje ndjenjat e tyre të zjarra të dashurisë së pakufishme për atdheun socialist, për Partinë tonë të Punës dhe për Udhëheqësin e dashur e të madh, shokun Enver Hoxha.*


*Nëpërmjet këtij botimi, ata vunë në dukje se sa e gjerë dhe e gjithanshme është mundësia dhe horizonti që ka çelur Partia jonë përpara të rinjve në çdo fushë të aktivitetit të tyre.*

*Duke marrë inisiativën për botimin e këtij vëllimi të përbashkët, të rinjtë e shkollave të qytetit tonë*

dhe anëtarët e rrethit letrar të pallatit të kulturës «Aleksandër Moisiu», japin një shembull të mirë se si duhet të veprohet me shkrimet që mbushin sirtaret e rretheve të shkollave, vatrave dhe shtëpive të kulturës.

Botimi i këtij vëllimi është një inkurajim për autorët e vegjël dhe i gëzon shumë ata e shokët e tyre.

Ethem Hysi



## DRITAT E PARTISË

Fluturo, o shqipe,  
lart nëpër ajri,  
si përhapet kënga  
mbushur me lavdi.

Lahuta malësore  
këngë të re ka nisë:  
i këndon Atdheut,  
i këndon Partisë.


Djersa porsi lumë,  
argjend e flori  
nga ball'i puntorit  
rrjedh për bukuri.

Oxhaku i fabrikës  
ngrihet përmbi re,  
dritat e Partisë  
shndrisin për mbi ne.

## **KËNDOJ PËR TY, ATDHE**

Për ty, e dashur Shqipëri,  
një zjarr i madh m'u ndez në gji  
dhe ja, një vjershë do të shkruaj,  
të shpreh të zemrës dashuri.

Për ty, i shtrenjti Atdheu im,  
më mbushet zemra plot gëzim  
kur shoh sa shpejt po përparon,  
kur shoh që ecën fluturim.



## TE QARTA ME VIJNE MENDIMET

Nga marshimi po kthehemi  
të lodhur,  
por më të fortë se kurrë.  
Qyteti na fton  
në gjirin e tij,  
me mijra drita.  
Dritë është gjithçka:



thirrja e Partisë,  
vepra e popullit.  
Sa të qarta më vijnë mendimet  
tani.

## KËNGË PËR XHAXHIN ENVER

N'ato ditë të rënda,  
plot mjerim e zi,  
i fale Atdheut  
të madhen Parti.

Popullin që vuante  
në mjerim e terr,  
e ngrite në këmbë,  
o xhaxhi Enver:

kushtrim' i Partisë  
në luftë për çlirim,  
flamur i lirisë,  
diell plot shkëlqim.